

## GJYKATA SUPREME

Numri i rastit:

Pml.Kzz 157/2014

(P.nr. 371/2010 Gjykata e Qarkut e Prishtinës)

(PAKR1175/2012 Gjykata e Apelit)

Datë:

2 tetor 2014

**Gjykata Supreme e Kosovës**, trupi gjykues në përbërje të gjyqtarës së EULEX-it Esmë (Gjyqtare kryesuese dhe raportuese), dhe gjyqtari i EULEX-it Timo Vuojolahti dhe gjyqtari i Gjykatës Supreme Salih Toplica si anëtarë të trupit gjykues, dhe Zyrtari ligjor i EULEX-it Kerry Kirsten Moyes si procesmbajtës, në lëndën penale me numër P.nr. 371/2010 Gjykata e Qarkut e Prishtinës kundër:

**FG**, i arrestuar më 13 korrik 2010, në arrest shtëpiak që prej datës 14 korrik 2010 deri më 19 gusht 2010 dhe në paraburgim që prej 19 gushtit 2010;

I akuzuar dhe gjetur fajtor për kryerjen e veprës penale të **Krime Luftë kundër Popullatës Civile**, në pajtim me nenin 22 dhe 142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KP i RSFJ-së), në kundërshtim me nenin 3 i përbashkët për katër konventat e Gjenevës të 12 gushtit 1949, dhe neni 4 i Protokollit II i datës 8 qershor 1977, duke ia shtuar Konventave të vitit 1949;

*duke vepruar me Kërkesën për Mbrojtjen e Ligjshmërisë* e ushtruar nga avokati mbrojtës Tahir Rrecaj më 5 qershor 2014 në emër të të pandehurit kundër Aktgjykimit (të atëhershëm) Gjykatës së Qarkut të Prishtinës më 23 nëntor 2011 në këtë rast dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit nga data 10 shkurt 2014.

*duke marr parasysh* Përgjigjen në Kërkesën e shtruar nga Prokuroria e Shtetit KMPL 113/14 më 25 korrik 2014;

*duke shqyrtuar dhe votuar më tetor 2014;*

*në pajtim me nenin 418 dhe nenet 432-441 të Kodit të Procedurës Penale (KPP)*

*shpallë këtë:*

---

## AKTGJYKIM

---

**Aprovohet pjesërisht Kërkesa për Mbrojtjen e Ligjshmërisë e ushtruar nga Avokati mbrojtës Tahir Rrecaj më 5 qershor 2014 në emër të të pandehurit kundër Aktgjykimit (të atëhershëm) të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës më 23 nëntor 2011 dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të datës 10 shkurt 2014. Dispozitivi i Aktgjykimit i Gjykatës së Apelit ndryshohet ku shtohet paragrafi 2 si në vijim: Koha e kaluar nga FG në arrest shtëpiak nga 14 qershor 2010 deri 18 gusht 2010, dhe koha e kaluar në paraburgim që prej 19 gushtit 2010 do të llogaritet në dënimi, në pajtim me nenin 50 paragrafi 1 i KP i RSFJ-së. Pjesa e mbetur e kësaj Kërkesë hedhet poshtë si e pabazë.**

### ARSYETIMI

#### **1. Historiku i procedurës**

**1.1.**Më 5 nëntor 2010 është ngritur një Aktakuze kundër të pandehurit **HR** duke e akuzuar për kryerjen e veprës penale të Krimeve të Luftës kundër Popullatës Civile në pajtim me nenin 22 dhe 142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KP i RSFJ-së). Aktakuza u confirmua me Aktvendimin e Gjykatës së Qarkut të Prishtinës të datës 21 dhjetor 2010. Pasi seanca kryesore ishte mbajtur më 15 mars 2011 dhe 22 nëntor 2011. Më 23 nëntor 2011 ishte shpallur aktgjykimi.

**1.2.**I pandehuri u shpall fajtor për veprën penale Krime Luftë kundër Popullatës Civile sepse më 15 qershor 1999 diku rreth orës 21:30 gjatë një konflikti të armatosur në Kosovë, në cilësinë e tij si pjesëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) dhe në bashkëkryerje me **NB** e kanë vrarë personin civil **SG** në shtëpinë e tij. Ai është dënuar me tetëmbëdhjetë (18) vite burgim, duke iu llogaritur koha e kaluar në arrest shtëpiak dhe paraburgim.

**1.3.**Më 16 maj 2012 Avokati Mbrojtës Tahir Rrecaj ka parashtruar ankesë në emër të të pandehurit, me propozim që i pandehuri ose të lirohet ose lënda të kthehet në gjykatën e shkallës së parë për rigjykim. Prokurori i Apelit ka paraqitur një përgjigje më 11 janar 2013, me propozimin që Gjykata e Apelit ta hedh poshtë si të pabazuar dhe ta aprovojë Aktgjykimin e Gjykatës së Shkallës së Parë. Gjykata e Apelit pjesërisht e ka aprovuar ankesën duke e ndryshuar Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut dhe duke e dënuar të pandehurin me katërmëdhjetë (14) vite burgim.

**1.4.** Është parashtruar një Kërkesë për Mbrojtje të Ligjshmërisë nga ana e Avokatit Mbrojtës Tahir Rrecaj më 5 qershor 2014 në emër të të pandehurit, dhe Përgjigjen në Kërkesë e kishte dhënë Prokurori i Shtetit më 25 korrik 2014. Që të dyja brenda afatit ligjor.

## 2. Pretendimet e Palëve

2.1. Avokati Mbrojtës pohon se ka pasur shkelje të ligjit penal, sipas nenit 404 paragraf 1 dhe nën paragraf 4 dhe paragraf 6 i KPP, në lidhje me nenin 142 dhe 22 i KPP, dhe shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës penale, neni 403 paragrafi 1 nën paragrafët 3, 8, 12 dhe paragrafi 2 nën paragrafi 1 dhe 2 i KPP.

- a. Avokati Mbrojtës pandeh se emërtimi ligjor i veprave është i gabuar pasi që lufta në Kosovë përfundoi më 9 qershor 1999, dhe pasi kjo datë është data e Marrëveshjes së Paqes. De fakto dhe de jure, vrasja kishte ndodhur pas përfundimit të luftës.
- b. Gjykata e Apelit nuk e ka llogaritur kohën e kaluar në arrest shtëpiak dhe në paraburgim me rastin e shqiptimit të dënimit.
- c. Aktgjykimi me shkrim i Gjykatës së Shkallës së Parë i ishte dorëzuar palës mbrojtëse më 9 maj 2012, pra me 9 muaj vonesë, në kundërshtim me nenin 403 të KPP dhe nenit 6 i Konventës Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut. Më tej, Gjykata e Apelit ka shkelur të drejtën për një gjykim të lirë brenda afatit kohor duke “harruar” se mbrojtja kishte e kishte parashtruar ankesë kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Shkalles së Parë.
- d. Gjykata e Apelit më tej vazhdon me shkelje të nenit 356 të KPP me seancë të mbajtur nga Trupi gjykues e ku i pandehuri ishte në gjendje të rëndë shëndetit mendor. I pandehuri gjithashtu kishte ankesa serioze fizike. Në këtë mënyrë, sipas nenit 412 të KPP, Gjykata e Apelit është dashur ta ndalonte shqyrtimin gjyqësor ose ta urdhëronte një ekspertizë ligjore për ta vërtetuar gjendjen mentale apo ta hidhte poshtë Aktgjykimin e Gjykatës së Shkalles së Parë dhe ta kthente çështjen në rigjykim.
- e. Dispozitivi i Aktgjykimit të kundërshtuar është i paqartë dhe në kundërshtim me përmbajtjen dhe arsyetimin e vet. Nuk përmban arsyetim as në pikat kyçe të vendimit e as në ofrimin e provave kundërthënëse.
- f. Gjykata e Shkallës së Parë e ka shkelur nenin 371.1 të KPP sepse është filluar me dëgjimin e të pandehurit në prezencën e dëshmitarit të mbrojtës **BD**. Nuk është e udhës që mbrojtja të pajtohet me këtë. Me këtë rast është shkelur ky nen pasi Gjykata nuk ka kërkuar nga i pandehuri **HR** ta lëshonte sallën, derisa po merrej në pyetje i pandehuri **FG**. Avokati mbrojtës nuk pajtohet me Gjykatën e Apelit kur kjo e fundit shfaq mospajtim lidhur me atë se kjo shkelje nuk ka qenë aq e rëndë sa për të arsyetuar anulimin e Aktgjykimit të Shkallës së Parë.
- g. Gjykata e Shkallës së Parë e ka bazuar Aktgjykimin e saj tërësisht nga provat e dhëna nga dëshmitari bashkëpunues **NB**, në kundërshtim me nenin 157 (4) të KPP. Mbrojtja ka kërkuar që disa pjesë nga deklaratat e këtyre dëshmitarëve të shpallen si të papranueshme, por këto kërkesa thjesht ishin injoruar. Deklaratat janë të pabazuara pasi që statusi i **NB** ka ndërruar nga të pozita e të pandehurit në dëshmitar.

- h. Urdhri i cili e shpall **NB** si dëshmitar bashkëpunues nuk i është dorëzuar të pandehurit sipas nenit 302 të KPP, dhe atyre u është mohuar e drejta për ta kundërshtuar urdhrin. Avokati mbrojtës nuk pajtohet me Gjykatën e Apelit se nuk ka të drejt të kundërshtohet ky urdhër, pasi i njëjti është vendosur përmes Aktvendimit të lëshuar nga Gjykatësi i procedurës paraprake sipas nenit 431 paragrafi 1 i KPP ku parashihet që një ankesë kundër Aktvendimit të lëshuar nga Gjykatësi i procedurës paraprake mund të paraqitet nga palët të cilave u është shkëlur e drejta përveç në rastet kur një ankesë e tillë kategorikisht ndalohe.
- i. Policia e EULEX-it kanë përdorë metoda të ndaluara të detyrimit dhe kërcënimeve ndaj **HR** që ta ndryshojë statusin e tij prej dëshmitari në atë të dyshuar. Metoda të njëjta janë përdorur nga Prokurori Publik gjatë fazës hetimore, për ta ndërruar statusin prej të dyshuarit në të pandehur me qëllim të qartë pengimin e tij nga dhënia e provave në mbështetje të të pandehurit **FG**.
- j. Aktakuza u konfirmua në kundërshtim me dispozitën e nenit 313 paragrafi 2 i KPP pasi që palët nuk kanë qenë prezentë dhe nuk kanë qenë të njoftuara lidhur me këtë.
- k. Gjykata e Shkallës së Parë e lejoi Prokurorin të parashtronte pyetje sugjестive dhe ka përsëritur të njëjtën pyetje ndaj dëshmitarit bashkëpunues dhe dëshmitarëve tjerë të thirrur nga Prokuroria. Prokurori gjithashtu ka sjellë dëshmitarin bashkëpunues edhe dy hera tjera në Gjykatë dhe ka kërkuar nga ai të korrigjohen deklaratat. Ai gjithashtu ka penguar dhe ka çorientuar mbrojtjen nga pyetjet e tyre dhe në mënyrë të vazhdueshme ka ndërhyrë ndaj mbrojtjes. Prokurorit gjithashtu i është lejuar ta urdhërojë dëshmitarin i cili nuk iu ishte përgjigjur ftesave gjyqësore të silltet me forcë.
- l. Trupi gjykues shkel rregullat mbi pranueshmërinë e provave pasi që Prokurorit i lejohet t'i përdorë si prova deklaratat e disa dëshmitarëve të cilët Prokurori ka pasur rastin t'i dëgjojë gjatë shqyrtimit kryesor gjyqësor.
- m. Lidhur me gjendjen faktike, Gjykata e Apelit gabimisht pranon vlerësimin e Shkallës së Parë lidhur me alibinë e të pandehurit. Gjykata gjithashtu nuk ka marr në pyetje shumë dëshmitarë të propozuar nga ana e mbrojtjes dhe asnjëherë nuk kishte lëshuar ndonjë Aktvendim.
- n. Deklarata e Aktgjykimit ku thuhet se i tërë materiali i lëndës është shpallur i papranueshëm, dhe se materiali ishte administruar gjatë rrjedhjes së seancave nuk qëndron. Trupi gjykues nuk ka lëshuar Aktvendim ku përmendet se deklarata shpallet e papranueshme apo jo, e as Gjykata nuk ka lëshuar Aktvendim mbi pranimin apo

refuzimin e propozimit nga ana e mbrojtjes për të dëgjuar një numër të dëshmitarëve dhe të administrohen si provë qindra mesazhe kërcënuese të dërguara nga **NB** tek i pandehuri dhe të tjerët.

- o. Gjykata e Apelit nuk e ka shqyrtuar ankesën e mbrojtjes në tërësi lidhur me gjendjen faktike, përmes së cilës mbrojtja pretendon se është gjendje e gabuar e pakompletuar. Paragrafët 88 deri te 165 nga Raporti i Avokatit Mbrojtës për Mbrojtje të Ligjshmërisë janë veçse përsëritje e pretendimeve që ai i ka përmendur në ankesën e tij lidhur me këtë çështje.

Avokati mbrojtës propozon që Aktgjykimet e kundërshtuara të ndryshohen dhe ta lirojnë klientin e tij, ose të anulohen dhe çështja të kthehet në rigjykim.

2.6. Prokurori i Shtetit i propozon Gjykatës Supreme ta vlerësojë nëse është shkelur e drejta e personit të akuzuar i cili e ka ndjekur rrjedhën e procedurave penale gjate seancës të mbajtur më 10 shkurt, dhe nëse jo, të llogaritet në dënim koha e kaluar në paraburgim dhe të hedhen poshtë të gjitha pretendimet tjera për Mbrojtjen e Ligjshmërisë si të pabaza kurse t'i aprovoj Aktgjykimet e kundërshtuara. Prokurori kujton se shumica e pretendimeve të ngritura me Kërkesën për Mbrojtjen e Ligjshmërisë ishin ngritur në ankesë.

- a. Prokurori pajtohet me vlerësimin e dhënë nga Gjykata e Shkalles së Parë lidhur me ekzistimin e vazhduar të konfliktit të brendshëm të armatosur gjatë kohës së kryerjes së veprës penale.

- b. Dispozitivi i Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit duhet ndryshuar dhe të shtohet se koha e kaluar në paraburgim të llogaritet në dënimin e të pandehurit.

- c. Vonesat për të cilat ankohet Avokati mbrojtës nuk kanë ndikuar me rastin e lëshimit të një Aktgjykimi të meritort dhe të ligjshëm dhe sa i përket nenit 403 paragrafi 2 i KPP, as edhe një shpjegim apo fakt nuk është ofruar.

- d. Prokurori gjen se në procesverbalin e shqyrtimit nga Gjykata e Apelit i pandehuri nuk ka reaguuar në pyetjet e parashtruara nga Kryetari i trupit gjykues, dhe se Avokati mbrojtës nuk ka qenë në gjendje t'i diskutojë çështje me të pandehurin gjatë ankesës. Sidoqoftë, Avokati mbrojtës deklaroi se nuk kishte pengesa në vazhdimin e seancës dhe Kryetari i trupit gjykues, bazuar në dispozitat procedurale ku prezenca e palëve nuk është e obligueshme gjatë seancës së apelit, ka urdhëruar vazhdimin e seancës dëgjimore.

- e. Dispozitivi i Aktgjykimeve të atakuara përmban të gjitha kriteret e parapara me ligj, duke paraparë edhe veprën mbi bazën e së cilës i pandehuri është gjetur fajtor, faktet si dhe rrethanat.

- f. Marrja në pyetje e dëshmitarit **BD** ishte bërë me kërkesë të Avokatit mbrojtës të të pandehurit, dhe gjithashtu ishte rënë dakord me propozimin e Kryetarit të trupit

gjykues mbi marrjen në pyetje të të pandehurit në prani të dëshmitarit. Neni 371 paragrafi 1 i KPPK nuk është shkelur me rastin e pranisë së **HR** gjatë pyetjeve të parashtruara ndaj z. **FG** dhe para marrjes së tij në pyetje. Avokati mbrojtës nuk ofron bazë për besimin se shkelja e sipërpërmendur ka ndikuar ose mund të ketë ndikuar në shqiptimin e një Aktgjykimi të ligjshëm dhe meritore, duke mos harruar se **HR** ka serish ka qëndruar prapa deklaratave të tij te dhëna më parë dhe ka refuzuar të merret në pyetje gjatë gjykimit.

g. Nuk ka pasur shkelje të nenit 157 paragrafi 4 të KPPK, pasi që deklaratat e dëshmitarit bashkëpunues nuk janë konfirmuar nga ndonjë prove direkte rrethore e paraqitur nga prokurori publik, dhe vlerësuar nga Gjykata e Shkallës së Parë. Avokati mbrojtës pretendon se shkelja e nenit 153 paragraf 2 dhe 154 paragraf 4 e KPPK nga Gjykata e Shkallës së Parë me rastin e lejimit të palëve që t'iu referohen deklaratave të dhëna nga **NB** gjatë hetimeve si i dyshuar apo i pandehur dhe se vendimi ka qenë i bazuar në prova të papranueshme. Prokurori do të duhej ta kishte marr në pyetje serish z. **NB** lidhur me të gjitha rrethanat e veprës penale pasi ai është bërë dëshmitar bashkëpunues. Prokurori vëren se Gjykata e Apelit nuk e ka adresuar këtë shkelje. Sidoqoftë, Avokati mbrojtës nuk e përmend dispozitën ligjore në mbështetje të pikëpamjes së tij. **NB** ishte marr në pyetje në pajtim me statusin të cilin e gëzonte në atë kohë; së pari si i dyshuar, pastaj si i pandehur dhe së fundmi si dëshmitar bashkëpunues. Procedurat e ndjekura kanë qenë në pajtim me dispozitat e KPPK ndërsa Avokati mbrojtës nuk iu ka referuar ndonjë dispozite ligjore e cila e parasheh papranueshmërinë e provave në rastin gjegjes, ose e cila qartazi e përshkruan obligimin t'i rimarr në pyetje ata të cilët pranojnë të bëhen dëshmitar bashkëpunues.

h. Neni 302 i KPPK parasheh që mbrojtja duhet ta merr një kopje të Urdhrit me të cilin deklarohet një person si dëshmitar bashkëpunues para shqyrtimit gjyqësor. Prokurori vë në dukje se mbrojtjes i është siguruar një kopje e Urdhrit gjatë seancës së Konfirmimit më 25 nëntor 2010. Një urdhër i tillë nuk është kundërshtuar në ankesë.

i. Prokurori vëren se Avokati mbrojtës ka përsëritur pretendimet lidhur me policinë dhe Prokurorin publik duke e ndryshuar statusin e **HR** përmes metodave të detyrimit dhe nën kërcënim. Neni 220 paragrafi 4 u ngarkon autoriteteve hetuese një detyrë të caktuar për trajtimin e cilitdo person si të pandehur në rast se gjatë mbledhjes së informatave atyre u behet me dije se personi ka kryer veprë penale për të cilën ndiqet sipas detyrës zyrtare.

j. Seanca për konfirmim e mbajtur me 25 nëntor 2010, ku edhe vet avokati mbrojtës ish prezent. Më 21 dhjetor 2010 Gjykatësi për Konfirmimin e aktakuzës ka lëshuar Aktvendimin mbi konfirmimin e Aktakuzës. Prokurori përfundon duke thënë se nuk ka pasur seancë dëgjimore më 21 dhjetor 2010. Palët kanë qenë të informuara me Aktvendim me shkrim mbi të drejtat e palëve lidhur me ankimimin e mundshëm, dhe avokati mbrojtës nuk e ka bërë një gjë të tillë.

k. Kërkesa e prokurorit ta thërras **NB** të dëshmojë ishte miratuar nga Trupi gjykues dhe nuk ishte kundërshtuar nga Avokati mbrojtës. Kjo ka qenë e bazuar në nevojën për të sqaruar disa çështje dhe për ta ballafaquar atë me disa deklaratat të dhëna nga dëshmitarët tjerë. Prokurori publik e kishte ndërprerë Avokatin mbrojtës vetëm me rastin e një kundërshtimi ndaj mënyrës se si po merrej në pyetje dëshmitari. Trupi gjykues kishte kërkuar nga prokurori të intervenonte dhe që dëshmitarët të merreshin nën shoqërimin e policisë. Trupi gjykues kishte deklaruar, lidhur me çështjen e ngritur nga Avokati mbrojtës, se kishte qenë kerkese e tyre e ushtruar zyrtarisht që dëshmitarët të sillen brenda nën shoqërimin e policisë, dhe me ndërmjetësim të Prokurorit publik ashtu që nuk kemi pasur të bëjmë më shkelje ligji.

l. Lidhur me Trupin gjykues i cili lejon Prokurorin ta shfrytëzojë deklaratat e dëshmitarit të marra nga Prokurori gjatë shqyrtimit kryesor si prova në gjykim, Prokurori vëren se asnjë dispozitë e Kodit nuk ia ndalon hetimet pas përpilimit të aktakuzës sikurse asnjë dispozitë e Kodit nuk ia ndalon Prokurorit të merr në pyetje dëshmitarët e propozuar nga mbrojtja.

m. Gjykata e Shkalles së Parë në tërësi ka vlerësuar dokumentet e paraqitura nga palët në mbështetje të alibisë së të pandehurit, dhe ka dëgjuar një numër të dëshmitarëve. Gjykata ka dhënë arsytim të kuptueshëm se përse ua ka dhënë ose jo ndonjë peshë dëshmive gjegjëse si dhe alibisë të deklaruar nga i pandehuri.

n. Prokurori shtetëror vëren se gjatë gjykimit palët nuk janë lejuar të paraqesin prova dhe propozime Gjykatës ta merr ndonjë provë shtesë si rezultat pas dëgjimit të ndonjë dëshmitari. Gjykata ka lëshuar Aktvendime me të cilat është vendosur lidhur me propozimet e mbrojtjes për dëgjimin e disa dëshmitarëve, dhe disa sende i janë kthyer mbrojtjes të cilësuar si prova të papranueshme.

o. Prokurori nuk pajtohet me pretendimet e Avokatit mbrojtës se vlerësimi i besueshmërisë në deklaratat e **NB** ishte në kundërshtim me vetveten. Avokati mbrojtës nuk qet përpara asnjë argument konkret me të cilin tregon se të gjeturat e Gjykatës nuk janë të drejta dhe shihet si i kufizuar në pohimin se ato janë të gabuara. Gjykata e Apelit me të drejtë i ka kushtuar Gjykatës së seancës gjyqësore një hapësirë të vogël të dallimit në arritjen e të gjeturave ngase ato të gjetura janë plotësisht të arsyeshme dhe nuk janë subjekt i ndonjë censure. Avokati mbrojtës pretendon se Aktgjykimet e kundërshtuara nuk përmbajnë vlerësim merititor të gjendjes faktike dhe ky thjesht është mospajtimi i tij i radhës me të gjeturat faktike të Trupit gjykues. Nuk lejohet asnjë kundërshtim ndaj këtyre bazave sipas nenit 451 paragrafi 2 i KPPK.

### 3. Të Gjeturat e Trupit gjykues

3.1 Kërkesa për Mbrojtjen e Ligjshmërisë nga Avokati mbrojtës dhe Përgjigjja e kthyer nga Prokurori i Shtetit janë të pranueshme dhe të paraqitura brenda afatit kohor.

3.2 Gjykata Supreme vëren se Avokati Mbrojtës ngre një mori çështjes me vlerësimin e provave nga Gjykata e Qarkut, në veçanti ato të lidhura me dëshmitarin bashkëpunues. Avokati Mbrojtës ia rikujton se Kërkesa për Mbrojtjen e Ligjshmërisë mund të parashtrohet vetëm në rastet kur kemi të bëjmë me shkelje të së drejtës penale, mbi bazën e shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës penale, ose nëse ka ndonjë shkelje tjetër të dispozitave të procedurës penale që kanë ndikuar në ligjshmërinë e atij vendimi gjyqësor. Kërkesa gjegjëse nuk mund të parashtrohet vetëm mbi bazën e vendimit të gabuar të dhe të pakompletuar gjendjes faktike (neni 432 i KPP). Gjykata Supreme pajtohet me Prokurorin e shtetit se përmbajtja e Kërkesës është në masë të madhe një përsëritje e Ankesës kundër Aktgjykimit të Shkallës së Parë. Është përhapur shumë dhe është shndërruar në një tendencë tek shumë Avokatë mbrojtës që të provojnë ta përdorin Kërkesën për Mbrojtjen e Ligjshmërisë si Ankesë të dytë, e që në fakt nuk do duhej të ndodhte kjo.

3.3 Në përgjithësi, Avokati mbrojtës thotë se që të dy Aktgjykimet nuk kanë sqaruar dhe treguar plotësisht se çfarë fakte janë gjetur dhe cilat kanë qenë arsyet për vërtetimin e tyre, ose të gjej se pse ato janë të pakuptueshme ose të kundërshtueshme. Gjykata Supreme kategorikisht hedh poshtë këto pretendime. Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut është i plotë dhe i qartë ndërsa sa i përket asaj se çfarë në fakt gjetur si e bazuar- përsëri, kjo është e precizuar në një mënyrë shumë të kuptueshme. Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit të saj njësoj e precizon në Arsyetimin e vet dhe është plotësisht e qartë edhe për sa i përket të gjeturave të saj. As Gjykata Supreme nuk mund të gjej ndonjë kundërshtim në mes të diapozitivit dhe arsyetimit në asnjërin prej Aktgjykimeve. Prandaj Trupi gjykues, duke u thirr në arsyetimin e gjendjes faktike në Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut dhe pa ndonjë arsye tjetër për të hyrë më në detaje të analizimit, nuk gjen ndonjë shkelje të dispozitave të nenit 403 (1) pika 12 e KPPK/ neni 384 (1) pika 12 e KPK siç pretendohet në Kërkesa.

3.4 Sa i përket llogaritjes së kohës së kaluar në paraburgim, Gjykata Supreme konsideron se ka qenë qëllimi i Gjykatës së Apelit ta modifikoj periudhën e dënimit prej 18 në 14 vite burgim, por llogaritja siç thuhet me dispozitivin e Aktgjykimit të lëshuar nga Gjykata e Qarkut mbetet e pandryshuar dhe duhet të llogaritet si e mbetur. Dosido, në mënyrë që të shmangen të gjitha paqartësitë, Kërkesa për Mbrojtje të Ligjshmërisë është pranuar pjesërisht që t'i shtohet diapozitivit të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit.

3.5 Avokati ka pretenduar se konflikti i brendshëm i armatosur ka përfunduar në kohën kur ishte kryer vepra, prandaj nuk mund të cilësohet si Krim Luftë. Trupi gjykues pajtohet me arsyetimin e detajuar të Gjykatës së Qarkut mbi këtë pikë, dhe gjithashtu vë në pah se shumë pjesë të cituara nga ligji i lidhur me lenden janë cituar nga Avokati mbrojtës dhe lidhen me ekzistimin e konfliktit të armatosur jo-ndërkombëtar, sesa në fokusimin e datave se kur ka filluar dhe kur është kryer. Tribunali ndërkombëtar për krime lufte në ish-Jugosllavi dhe Gjykata Supreme e Kosovës në disa raste kanë pohuar vazhdimisht konfliktin e armatosur jo-



ndërkombëtar së paku që prej pranverës 1998 e tutje në mes forcave të armatosura të (qeverisë) së Serbisë dhe UÇK-së, ku ka vazhduar edhe në vitin 1999<sup>1</sup> Dhoma Gjyqësore e TNKJ-së në rastin e *Milutinović* dhe *Dorđević* në mënyrë të qartë mendonte se konflikti i armatosur ka vazhduar deri në qershor të vitit 1999. <sup>2</sup> Megjithatë, në këto dokumente nuk ka referencë të veçantë që është bërë si një datë që shënon fundin e konfliktit të armatosur, përveç në muajin qershor 1999. Megjithatë, pavarësisht nënshkrimit të Marrëveshjes Teknike Ushtarake midis Forcës Ndërkombëtare të Sigurisë (KFOR) dhe qeverive të Republikës Federale të Jugosllavisë (RFJ) dhe Republikës së Serbisë më 9 qershor 1999, ku parashihet që forcat të tërhiqeshin brenda 11 ditëve, çështja për t'u marrë parasysh është nëse ka pasur forca të armatosura në vend, sulme apo përplasje edhe pas 9 qershorit 1999. Dihet se më 20 qershor 1999 forcat e RFJ-së janë vërtetuar si të larguara nga Kosova dhe NATO-s shpalli fundin zyrtar të fushatës së saj bombarduese kundër RFJ-së. Më 21 qershor 1999 KFOR-i dhe UÇK-ja lidhën një Marrëveshje Demilitarizimi ku UÇK-ja u zotua të ndërpriste luftimet menjëherë dhe të përfundojë çmilitarizimin e vet brenda 90 ditëve. RFJ zyrtarisht hoqi gjendjen e luftës më 26 qershor 1999. Në këtë drejtim, Gjykata Supreme thirret dispozitën e nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50 e cila i referohet në mënyrë eksplicite një afati kohor të konfliktit të armatosur, si që ka ndodhur në mes të 27 shkurtit dhe 20 qershorit 1999”.

Prandaj, Gjykata Supreme konsideron se 15 qershori 1999 I bie brenda periudhës së konfliktit të armatosur në Kosovë.

Në lidhje me kohën kur ka ndodhur shkelja e supozuar penale, ekzistenca e një konflikti të brendshëm të armatosur midis UÇK-së dhe forcave serbe është vërtetuar edhe nga Gjykata Supreme e Kosovës, në Vendimin *Kolasinac* më 5 Gusht 2004 dhe në Vendimin *Latif Gashi* të datës 21 korrik 2005. <sup>3</sup> prandaj, trupi gjykues nuk konsideron se ka pasur shkelje në lidhje me kualifikimin e veprës.

3.6. Avokati mbrojtës pretendon se atij nuk i ishte dhënë një kopje e Urdhrit që e shpall **NB** si dëshmitar bashkëpunues para shqyrtimeve kryesore sipas nenit 302 të KPPK. Prokurori pretendon se avokatit mbrojtës ishte i dorëzuar një kopje e Urdhrit gjatë seancës më 25 nëntor 2010. Trupi gjykues ka shqyrtuar procesverbalin e seancës, dhe është e qartë se çështja e Urdhrit është ngritur nga avokati mbrojtës atë ditë, edhe pse Urdhri është kopjuar dhe i atij I është dhënë një kopje. Kushtet sipas nenit 302, pra janë plotësuar. Avokati mbrojtës ka ngritur edhe çështjen për të nëse ankesa kundër një Urdhri të tillë është në dispozicion. Dispozitat lidhur me Dëshmitarin bashkëpunues fillon në nenin 298 të KPPK, ku thuhet se një Urdhër i tillë mund të jetë 'revokuar "nga një prej tre gjyqtarëve të trupit gjykues në kushte të caktuara sipas nenit 301 (dhe të cilat nuk përfshihen në kërkesën e të pandehurit apo të Avokatit Mbrojtjes). Askund nuk ka detaje që një procedurë për një Urdhër të tillë të apelohej. Prandaj, Trupi gjykues interpreton dispozitat në të njëjtën mënyrë si Prokurori që e

---

<sup>1</sup> Shih p.sh. Prokurori kunder Milan Milutinovic, ICTY, Aktgjykim nga gjykimi më 26 shkurt 2009, Volum I 1 Aktgjykimit, paragrafet 840-84; Prokurori kunder Vlastimir Dorđević, ICTY, Aktgjykim nga gjykimi I 23 shkurtit 2011 par 1579

<sup>2</sup> *Ibid.*

<sup>3</sup>

ka bërë dhe Gjykata e Apelit, në atë ankesë kundër Urdhrit I cili shpall një person të jetë Dëshmitar bashkëpunues nuk është paraparë në KPPK, dhe se për këtë arsye nuk ka pasur shkelje të procedurës penale.

3.7. Është po aq e qartë se seanca e dëgjimit të 25 nëntorit 2010, në të cilën i pandehuri dhe avokati mbrojtës ishin të pranishëm, ishte Seanca për Konfirmimin e Aktakuzës. Pasi Mbrojtja ka shprehur dëshirën në atë kohë të marr në konsideratë Urdhrit i cili e shpall **NB** dëshmitar bashkëpunues, gjyqtari I Konfirmimit të aktakuzës i lejoi deri javën e ardhshme për të bërë deklaratat me shkrim. Nuk kishte asnjë seancë dëgjimore më 21 dhjetor 2010. Konfuzioni duket se kanë lindur si i rezultat I gjyqtarit për konfirmim e ka caktuar datën në Aktvendim tij për 21 dhjetor 2010 në vend se ta shkruante 25 nëntor të vitit 2010. Prandaj nuk ka pasur asnjë shkelje të procedurës penale.

3.8. Është e qartë dhe e pamundur për Gjykatën Supreme tani spekulohet mbi atë se cila ka qenë gjendja e shëndetit mendor të të pandehurit gjatë shqyrtimit gjyqësor pranë Gjykatës së Qarkut. As nuk ka ndonjë tregues se i pandehuri nuk ka marrë pjesë rregullisht në mbrojtjen e tij, ose se ka pasur ndonjë problem rreth komunikimit me mbrojtësit e tij, i cili nuk e ka ngritur ndonjë shqetësim në atë kohë. Lidhur me seancën e Gjykatës së Apelit, Trupi gjykues bazohet te neni 410 i KPPK, dhe se është e qartë se nuk është e detyrueshme për të pandehurin të jetë i pranishëm. Paragrafi 2 thotë se i akuzuari mund të marrë pjesë në seancën e nëse ai dëshiron, dhe paragrafi 4 thotë se Gjykata e Apelit mund të mbajnë seancën edhe në qoftë se ata që janë ftuar nuk marrin pjesë. Pasi procesverbali i seancës të bën të qartë, se në asnjë moment Avokati Mbrojtës nuk ka sugjeruar që seanca mos të vazhdojë, dhe në fakt ka deklaruar se nuk kishte asnjë pengesë për të vazhduar me seancën atë ditë. Përndryshe, trupi gjykues nuk e sheh si ndonjë përkeqësim i mëvonshëm në shëndetin mendor (ose fizike), të pandehurit mund të ketë ndikuar në shqiptimin e aktgjykimit të ligjshëm dhe të rregullt.

3.9. Gjykata e Apelit konstatoi shkelje të Nenit 371 paragrafi 3 (në lidhje me **HR**), por se kjo nuk është mjaft serioze për të justifikuar anulimin e aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut, si nuk ka baza për të besuar se kjo shkelje ka ndikuar në shqiptimin e aktgjykimit të ligjshëm dhe të rregullt. Trupi gjykues konsideron se kërkesa që të pandehurit e bashkë-akuzuar mos të jenë të pranishëm kur njërin prej tyre ose të tjerët janë duke u marr në pyetje gjatë gjykimit është relevante vetëm kur ata janë të paditur për të njëjtën vepër penale ose vepra penale. Është e qartë se qëllimi është për të parandaluar mundësinë nga të qenit ndikuar në dëshmitë e tyre duke dëgjuar dëshmitë e tyre nga të bashkë-akuzuarit për llogarinë ata japin nga rrethanat që kanë të bëjnë me vepër të veçantë penale. Është e qartë se provat do të merren me një kohë, vend dhe ngjarje të veçantë. Megjithatë, në këtë rast ky i pandehur dhe të akuzuarit tjerë ishin të akuzuar për vepra të ndryshme. **FG** është akuzuar për krime lufte, ndërsa i bashkë-akuzuari **HR** e tij u akuzua për Dhënia e Ndhmës Kryerësve pas Kryerjes së Veprave Penale. Prandaj, në këtë rast dispozita bëhet e parëndësishme, dhe si rezultat, Gjykata Supreme konstaton se nuk ka pasur shkelje të procedurës penale.

3.10. Gjykata e Apelit vuri në dukje se ishte mbrojtja e cila kërkoi që Trupi Gjykues dëgjoi të pandehurin para një dëshmitari (**BD**), në kundërshtim me Nenin 371 paragrafi 1. Avokati Mbrojtës tani pohon se kjo është një shkelje e procedurës penale. Gjykata Supreme

konsideron se kërkesa në nenin 371 paragrafi 1 nuk është një rregull absolut. Ka disa dispozita të cilat lejojnë për mundësinë që të dëgjohen dëshmitarët në intervale të ndryshme kohore në gjyq. Për shembull, edhe pas përfundimit të procedurës së provave, kështu që pas marrjes në pyetje të të akuzuarit, kryetari i trupit gjykues i pyet palët nëse kanë propozim për plotësimin e procedurës së provave (neni 374,1). Trupi gjykues konstaton se nuk ka asnjë shkelje të procedurës penale, si dhe nuk ka tregues se mënyra e renditjes gjatë marrjes së provës ka ndikuar në shqiptimin e aktgjykimit të ligjshëm dhe të duhur.

3.11. Gjykata Supreme vëren se duhet të jetë një Aktvendim i veçantë nga kryetari i trupit gjykues në çështjen se cila provë është e papranueshme. Duket se kjo nuk është bërë, dhe se ka pasur një shkelje të procedurës penale. Megjithatë, trupi gjykues konstaton se kjo nuk ishte një shkelje substanciale. Është e qartë se palët janë lejuar t'i propozojnë gjykatës mbledhjen e provave shtesë si rezultat nga dëgjimi i dëshmimeve të dëshmitarëve. Aktvendimet janë lëshuar më 5 gusht 2011 dhe 7 shtator 2011 me propozimin e mbrojtjes për të dëgjuar disa dëshmitarë, dhe më 7 qershor 2011 sendet janë kthyer në mbrojtës si prova të papranueshme. Më tej, më 21 tetor 2011 Kryetari i trupit gjykues ka bërë të qartë se çfarë kishte qenë pranuar dhe çka nuk ishte pranuar. Prandaj, Trupi gjykues vjen në përfundim se avokati mbrojtës nuk ka qenë penguar në aftësinë e tij për të paraqitur mbrojtjen, dhe nuk ka asnjë tregues se kjo ka ndikuar në drejtësinë e gjykimit, apo të ndikojë në shqiptimin e aktgjykimit të ligjshëm dhe të rregullt.

3.12. Avokati Mbrojtës përsërit pretendimet e tij të kërcënimeve dhe shtrëngimeve nga ana e policisë dhe prokurorit publik dhe gjithashtu merret me çështjen me sjelljes së Prokurorit gjatë gjykimit. Avokati mbrojtës gjithashtu kundërshton hetimet që janë në diskrecionin e Prokurorit. Sjellja gjatë gjykimit edhe e avokatëve është çështje e kryetarit të trupit gjykues, dhe Gjykata Supreme mund të zbulojë asnjë shkelje të procedurës penale. Avokati Mbrojtjes ngre përsëri çështjen e transportit të dëshmitarëve në Gjykatë. Është e qartë nga procesverbali i gjykimit se kjo ishte me kërkesë të Panelit.

3.13. Lidhur me vonesat që Avokati mbrojtës përjetoi me rastin e pranimit të aktgjykimit me shkrim dhe në vendosjen e ankesës, Gjykata Supreme e ka me dije ekzistimin e dispozitave të KPPK, Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (ECHR), ka paraqitur disa udhëzime, edhe pse në jurisprudencën e saj, në lidhje me çështjen e të drejtës së secilit për një seancë dëgjimore "brenda një afatit të arsyeshëm kohor", siç përcaktohet në nenin 6 (E drejta për një gjykim të drejtë), i cili thotë:

3.14. Në përcaktimin lidhur ... me ndonjë akuze penale kundër tij, çdokush ka të drejtë për një gjykim të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm kohor nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj ...".

GJEDNJ ka konstatuar se periudha në të cilën neni 6 është zbatuar dhe ka mbuluar tërë procedurën në fjalë, për të përfshirë procedurat e apelit.<sup>4</sup> Ku ka një bindje, se nuk ka asnjë

---

<sup>4</sup> Delcourt k. Belgjikës, janar 17, 1970, Seria A nr. 11 §§ 25-26; Konig v. Gjermani, nr. 6232/73, 28 qershor 1978, Seritë A nr. 27 § 98; V. v. Mbretëria e Bashkuar [GC], nr. 24888/94, ECHR 1999-IX § 109

"përcaktim ... e lidhur me ndonjë akuze penale, brenda kuptimit të nenit 6, për aq kohë sa dënimi nuk është i caktuar<sup>5</sup> përfundimisht. Neni 6 kërkon që procedurat gjyqësore të jenë të shpejta, por ai nen gjithashtu parasheh parimin më të përgjithshëm të administrimit të duhur të drejtësisë, dhe një ekuilibër të drejtë ku duhet të arrihet në mes të aspekteve të ndryshme të kësaj kërkesë themelore.<sup>6</sup> Ku përcaktohet nëse kohëzgjatja e procedurës penale ka qenë e arsyeshme, pastaj nëse GJEDNJ ka pasur parasysh faktorë të tillë si kompleksitetin e çështjes, sjelljen e parashtruesit të kërkesës si dhe sjelljen e autoriteteve përkatëse administrative dhe gjyqësore. Neni 6 vendos detyrimin për autoritetet gjyqësore të organizojnë sistemet e tyre gjyqësor në mënyrë që gjykatat e tyre të mund të përmbushin secilën nga kërkesat e me atë nen.

Në vijim janë rastet kur GJEDNJ konstatoi se "një kohë e arsyeshme" ishte tejkaluar:  
- 9 vjet e 7 muaj, pa ndonjë kompleksitet të veçantë, përveç numrit të njerëzve të përfshirë (35), pavarësisht masave të marra nga autoritetet për t'u marrë me ngarkesën e punës të jashtëzakonshme nga ana e gjykatës pas një periudhe të trazirave.<sup>7</sup>

-13 vjet dhe 4 muaj, me problemet politike në rajon dhe ngarkesës me raste të grumbulluara nëpër gjykata, përpjekjet e shtetit për të përmirësuar kushtet e punës së gjykatave nuk kane filluar deri para disa viteve.<sup>8</sup>

5 -Vjet, 5 muaj dhe 18 ditë, duke përfshirë edhe 33 muaj në mes të dorëzimit të aktgjykimit dhe prodhimit të versionit të plotë me shkrim nga gjyqtari përgjegjës, pa marrjen e ndonjë masë adekuate disiplinore.<sup>9</sup>

-5 Vjet dhe 11 muaj, ndërlikimi i rastit për shkak të numrit të njerëzve për t'u marrë në pyetje dhe natyrën teknike të dokumenteve për shqyrtim në një rast të shpërdorimit të rëndë, edhe pse kjo nuk mund të justifikojë një hetim që kishte marrë pesë vjet dhe dy muaj kohë; gjithashtu, një numër i periudhave të pasivitetit u atribuohen autoriteteve. Kështu, derisa gjatësia e fazës së gjykimit shfaqet e arsyeshme, për hetimin nuk mund të thuhet është kryer me zell.<sup>10</sup>

-12 Vjet, 7 muaj dhe 10 ditë, pa ndonjë kompleksitet të veçantë ose ndonjë taktikë nga ana e parashtruesit të kërkesës për të vonuar procedurën, por duke përfshirë një periudhë prej dy vjetësh dhe më shumë se nëntë muaj në mes të depozitimit të

---

<sup>5</sup> Boddaert v. Belgium 12 Tetor 1992 Seria A nr. 235-D § 39

Abdoella v. Holanda, 25 nëntor 1992, Seria A nr. 248-A §24; Dobbartin v.France, 25 shkurt, 1993, Seritë A nr. 256-D § 44

<sup>6</sup> Boddaert v. Belgjikë 12 Tetor 1992 Seria A nr. 235-D § 39

Abdoella v. Holanda, 25 nëntor 1992, Seria A nr. 248-A §24; Dobbartin v.France, 25 shkurt, 1993, Seritë A nr. 256-D § 44

<sup>7</sup> Milasi v. Italisë, 25 qershor 1987, drejtuar Seria A nr. 119 §§ 14-20

<sup>8</sup> Baggetta v. Italisë, 25 qershor 1987, drejtuar Seria A nr. 119 §§ 20-25

<sup>9</sup> B. v. Austria, 28 mars 1990, e Seria A nr. 175 §§ 48-55

<sup>10</sup> Rouille v. France, nr. 50268/99, 6 janar 2004 § 29

propozimit pranë gjykatës administrative dhe pranimit i parashtrësive fillestare nga autoritetet tatimore.<sup>11</sup>

Në vijim janë rastet kur GJEDNJ konstatoi se "një afat kohor i arsyeshëm" nuk ishte tejkualuar:

- 5 vjet dhe 2 muaj, kompleksiteti i rasteve të lidhura të mashtrimit dhe të falimentimit mashtruese, me kërkesa të panumërta dhe ankesave nga ana e ushtruesit të kërkesës jo thjesht për lirimin e tij, por edhe duke sfiduar shumicën e gjyqtarëve në fjalë dhe duke kërkuar transferimin e procedimeve nën juridiksione të ndryshme.<sup>12</sup>

- 7 vjet e 4 muaj: fakti se më shumë se shtatë vjet kishin kaluar tashmë që nga shtruarja e akuzave pa qenë të përcaktuar në një aktgjykim dënues or lirues për të akuzuarin sigurisht se ka kaluar një periudhë jashtëzakonisht e gjatë e cila në shumicën e rasteve duhet të konsiderohet si në tejkualim i asaj që njihet si e arsyeshme; për më tepër, për 15 muaj gjyqtari nuk e kishte marrë në pyetje asnjë prej të bashkakuarve ose dëshmitarëve ose se paku të kishte kryer ndonjë detyrime tjetër; megjithatë, rasti ka qenë veçanërisht kompleks (numri i akuzave dhe personave të përfshirë, dimensionimi ndërkombëtar ngërthen vështirësi të veçanta në zbatimin e kërkesave për ndihmë juridike jashtë vendit, etj.).<sup>13</sup>

3.14. Nëse shqyrtojmë kohën e përgjithshme që procedimet penale në këtë rast kanë marrë, Gjykata Supreme konstaton se, me keqardhje dhe në shkelje të procedurës penale, vonesat që ky rast ka përjetuar nuk përbëjnë shkelje të së drejtës për një gjykim të drejtë në bazë të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ky është një rast i ndërlikuar dhe i ndjeshëm, duke përfshirë dokumentet e shumta të cilat duhej të vlerësoheshin dhe të përktheheshin, dhe ka përfshirë dëshmi nga një numër i madh i seancave dhe dëshmitarëve.

Më tej, Kryetari i trupit gjykues ka shfaqur ndjeshmërinë e duhur për çështjen e vonesës duke iu drejtuar me shkrim kryetarit të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës në këtë temë. Nuk ka indikacione se as ligjshmëria e as vendimi i Gjykatës së Qarkut apo ai i Gjykatës së Apelit, janë prekur lidhur me të drejtat e të pandehurit të garantuara me konventat ndërkombëtare.

### Përfundim

Paneli i Gjykatës Supreme nuk ka gjetur asnjë shkelje siç parashikohet me nenin 432.1 të KPP. Kështu, që kërkesa refuzohet.

E përpiluar në anglisht, si gjuhë zyrtare

<sup>11</sup> Clinique Mozart SARL k. Francës, nr. 46098/99, 8 qershor 2004 §§ 34-36

<sup>12</sup> Ringeisen v. Austria, nr. 2614/65, 16 korrik 1971 Seria A nr. 13 § 110

<sup>13</sup> Neumeister v. Austria, 27 Qershor 1968 Seria A nr. 8 § 21

**Kryetari i trupit gjykues**

---

Esmë Erterzi

Gjykatëse e EULEX

**Anëtarët e trupit gjykues**

---

Timo Vuojolahti

Gjykatës i EULEX

**Procesmbajtësi**

---

Kerry Kirsten Moyes

Zyrtar Ligjor I EULEX

---

Salih Toplica

Gjykatës Gjykata Supreme